



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN

KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____.____.2024

Shtojca 12

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT 2
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Data 27.11.2024

Drejtuar: Operatorit ekonomik “BARDHI” SHPK, **Adresa:** Lezhe Lac Ndermarrja Komunale lagjja nr.1, me nr.pronesia 1/317, Zone Kadastrale nr.2364.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” Shërbime (Prokurim me mjete elektronike).

Numri i procedurës / referenca: **REF-01343-04-15-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Pastrimi, grumbullimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane dhe të ngurta, Mirëmbajtja e hapësirave publike dhe e varrezave për Njësinë Administrative Lac”.

Fondi limit: **198,499,180** (njëqind e nëntëdhjetë e tetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.20, datë 22.04.2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të kësaj ju informojmë se, Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “BARDHI” SHPK, me numër NIPTI J67902364U.

Vlera e ofertuar: 186,496,955 (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë **pa TVSH.**

2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK me numër NIPTI L28029301Q & “S I L V E R” SHPK me numër NIPTI K88010301S.

Vlera e ofertuar: 188,986,086.60 (njëqind e tetëdhjetë e tetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “REJ” SHPK, me numër NIPTI J93711608Q.

Vlera e ofertuar: 191,640,278.13 (njëqind e nëntëdhjetë e një milion e gjashtëqind e dyzet mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë pikë trembëdhjetë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK me numër NIPTI L28029301Q & “S I L V E R” SHPK me numër NIPTI K88010301S.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....”, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

Referuar Vendimit Nr.1506/2024, datë 25.10.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, KVO procedoi me rivlerësimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “V.A.L.E. Recycling” SHPK & “Silver” SHPK, në sistemin e prokurimit elektronik, duke e s’kualifikuar sipas konstatimeve të KPP-së, me argumentimin si më poshtë vijon:

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Rej” SHPK për BOE “V.A.L.E Recycling” SHPK & “Silver” SHPK se: “OE VALE Recycling shpk duhet te skualifikohet pasi ne piken 2.2.2 te Kapacitetit Ekonomik te DT-ve, eshte kerkuar:

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2021, 2022, 2023) të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. OE VALE Recycling shpk ka dorëzuar bilancet e viteve 2021, 2022 dhe 2023 te pa shoqëruara me akt ekspertizen Ekspertit kontabel te Autorizuar”, pretendim i cili rezulton i pranuar nga KSHA,.....
.....III.3.1. Në shtojcën 8, “Kriteret e vecanta të kualifikimit”,

“Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 2.2.2, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë:

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2021, 2022, 2023) të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.....**Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “V.A.L.E Recycling” SHPK, konstatohet se nuk është paraqitur asnjë akt ekspertizë nga Ekspert Kontabël të Autorizuar, megjithëse rezultojnë se nga pasqyrat financiare për vitet 2021, 2022 dhe 2023, tejkalohej të paktën dy prej tre treguesve dhe konkretisht totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel për secilin nga të tre vitet e kërkuara kalon shumen prej 50 miliona lekesh dhe shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) për secilën nga të tre periudhat kontabel (2021, 2022 dhe 2023) kalon shumen prej 100 miliona lekesh. Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.....**

.....**KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve.**

Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër bashkimi i operatorëve ekonomikë “V.A.L.E. Recycling” SHPK & “Silver” SHPK, në zbatim të Vendimit Nr.1506/2024, datë 25.10.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, **S’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur asnjë akt ekspertizë nga Ekspert Kontabël i Autorizuar për bilancet.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**BARDHI**” SHPK, me adresë: Lezhe Lac Ndermarrja Komunale lagjja nr.1, me nr.pronesia 1/317, Zone Kadastrale nr.2364, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej: **186,496,955**

(njëqind e tetëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Kurbin, adresa: Lagjia Nr.3, Laç (në zyrën e protokollit të Bashkisë Kurbin), sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar, tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej: **191,640,278.13** (njëqind e nëntëdhjetë e një milion e gjashtëqind e dyzet mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë pikë trembëdhjetë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO X

Vendim Nr.1506/2024 datë 25.10.2024 i Komisionit të Prokurimit Publik.

Shënim: Ky formular është marrë nga DST e hedhur në SPE lidhur me këtë procedurë.

Titullari i Autoritetit Kontraktor
Majlinda CARA